



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

**RREGULLORE PËR
EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL**

Prishtinë, tetor 2023

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK-së) në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 20, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, si dhe Nenin 18, paragrafi 5 te Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OSK-së, e miratuar në mbledhjen e datës 16 maj 2019, e plotësuar dhe ndryshuar në mbledhjen e mbajtur me datë 17.10.2023, miraton këtë:

RREGULLORE PËR EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL

(Teksti i spastruar me plotësimë dhe ndryshime të miratuara nga Kuvendit i OSK-së, me datë 17.10.2023)

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, llojet, programet dhe procedurat e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në vazhdim EVP), akreditimi i programeve të EVP-së, vlerësimin e të gjitha formave të EVP-së dhe çështjet tjera të rëndësishme që ndërlidhen me EVP.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet ekskluzivisht për mbikëqyerjen, vlerësimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të EVP-së për stomatologët, si dhe për valorizimin e pikëve kredituese për rilicencimin e tyre.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet e përdorura në tekstin e kësaj rregulloreje, në zbatim të kësaj rregulloreje kanë këto kuptime:
 - 1.1 **EVP** – nënkuption Edukimin e Vazhdueshëm Profesional,
 - 1.2 **Aktivitetet e EVP-së** – nënkuption ngjarjet e organizuara nga institucionet shëndetësore-arsimore apo shoqatat profesionale që kanë karakter profesional dhe që organizohen me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të stomatologëve,
 - 1.3 **Pikët kredituese** – nënkuption sistemin e vlerësimit të ngjarjeve që ndiqen nga stomatologët për qëllime të EVP-së,
 - 1.4 **Oda** – nënkuption Odën e Stomatologëve të Kosovës,
 - 1.5 **KD** – Këshilli Drejtues i Odës
 - 1.6 **Komisioni për EVP** – nënkuption organin kompetent të Odës i cili zbaton, mbikëqyrë, planifikon dhe vlerëson aktivitetet e EVP-së.

2. Termat dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij nenit, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

Neni 4

Përbërja dhe funksionimi i Komisionit për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

1. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (në vazhdim KEVP) është organ i Odës, i cili përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve që janë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës, në përputhje me dispozitat e Statutit të Odës dhe akteve normative të Odës.
2. Puna dhe procedurat e vendimmarrjes së KEVP-së janë të rregulluara me Rregulloren për Procedurat e Vendimmarrjes së Organeve të Odës.
3. Mënyra e zgjedhjes, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KEVP-së rregullohet me akt të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të Odës.

Neni 5

Ushtrimi i kompetencës së KEVP-së

1. KEVP do të ketë këto kompetenca dhe përgjegjësi në:
 - 1.1 Zbatimin e procedurave të veçanta administrative për evidentimin e EVP-së;
 - 1.2 Akreditimin e aktiviteteve të EVP-së;
 - 1.3 Akreditimin e planeve vjetore dhe programeve për EVP;
 - 1.4 Valorizimin e pikëve të fituara nga anëtarët e Odës në angazhimin e tyre në procesin e EVP-së për nevojat e rilicensimit;
 - 1.5 Menaxhimin e regjistrat të aktiviteteve të EVP-së;
 - 1.6 Në bashkëpunim me Komisionin për Licencim, përcjellë evidencën e profileve profesionale të anëtarëve të Odës në procesin e EVP-së; dhe
 - 1.7 Kryen edhe funksione të tjera sipas nevojave për plotësimin e qëllimit të kompetencës publike për EVP, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe akteve të brendshme normative të Odës.
2. KEVP bashkëpunon dhe në mënyrë të vazhdueshme kontakton me organet tjera të Odës, në veçanti me Këshillin Drejtues, për çështjet që janë në interes të përgjithshëm të Odës.

Neni 6
Definicionet mbi aktivitetet e EVP-së

1. Me qëllim të unifikimit të terminologjisë së aktiviteteve të EVP-së dhe zbatimit të kësaj rregulloreje, me dispozita të këtij nenii disa nga termet kanë këtë kuptim:
 - A. **Kongresi/konferenca** - janë një takim i një grupei të madhe të profesionistëve, i organizuar sipas një programi të përcaktuar paraprakisht, ku diskutohen tema profesionale dhe shkencore, ku arrihen konkluzioni apo vendime mbi ngjarjet e zhvilluara. Organizohet në seancë plenare dhe/ose seanca paralele apo punëtori, prezantime orale, prezantime poster, etj. Punimet e prezantuara në kongres publikohen në përbledhjen e punimeve, përbledhjen e abstrakteve apo në revista profesionale.
Kongresi/konferenca përcjellet me ekspozitë të pajisjeve dhe materialeve stomatologjike.
 - B. **Simpoziumi** - është një takim shkencor i organizuar në nivel vendor ose ndërkombëtar që mund të zgjasë më shumë se një ditë, ku një temë e caktuar diskutohet nga disa ekspert para audiencës.
 - C. **Seminari** - është një formë aktiviteti me një grup pjesëmarrësish prej 5-50. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë rreth një çështje të caktuar duke diskutuar artikuj të caktuar, studime të ndryshme, që lidhen me çështjen. Seminari drejtohet nga ligjëruesi/ët dhe zgjat 2-3 orë.
 - D. **Trajnimi** - është një aktivitet mësimor në grup pjesëmarrësish i orientuar kryesisht drejt praktikës profesionale. Qëllimi është që pjesëmarrësit të përfitojnë njohuri, aftësi/shprehi ose kompetencia për të përbushur një detyrë apo punë në mënyrë të kënaqshme. Trajnimi mund të jetë 1 ditor apo më shumë.
 - E. **Kurs profesional** - është një aktivitet me një grup të caktuar pjesëmarrësish. Qëllimi është përfshirja aktive e pjesëmarrësve në diskutime dhe zgjidhjen e problemeve, në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi të ndihmuar nga eksperti/trajneri. Drejtohet nga trajneri.
 - F. **Ligjératë profesionale** - një leksion për një temë të caktuar që duhet të zgjasë të paktën 45-60 minuta. Numri i pjesëmarrësve në një ligjératë është i pakufizuar.
 - G. **Aktivitetet e të mësuarit në distancë** - janë aktivitete që kryhen në mënyrë të pavarur nga profesionisti, me ndihmën e teknologjisë moderne. Studimi i materialeve të shkruara, video-konferencat, web-konferencat, web-inaret dhe komunikimi nëpërmjet kompjuterit e lejojnë profesionistin të ndjekë një program trajnimi me interes për të, pa pasur nevojë për prezencë fizike në një aktivitet të tillë.
 - H. **Aktivitet kërkimor/studimor**, përfshirja e profesionistit në punë kërkimore, në shkrime artikujsh apo materialesh të tjera profesionale dhe shkencore.
 - I. **Aktivitetet e paspecifikuara** - do të vlerësohen sipas vlerësimit të KEVP-së, për secilën ngjarje në veçanti.
2. Karakteri kombëtar apo ndërkombëtar i një aktiviteti të EVP-së, përcaktohet në bazë të pjesëmarrjes së ekspertëve të stomatologjisë. Një aktivitet i EVP-së në Kosovë mund të marrë karakter ndërkombëtar nëse të paktën $\frac{1}{2}$ e Komitetit shkencor dhe $\frac{1}{2}$ e pjesëmarrësve aktiv (ligjërues, autor) janë nga vendet tjera dhe prezantimet e tyre bëhen në gjuhën angleze.

Neni 7
Parimet e edukimit të vazhdueshëm profesional

1. Parimet e EVP-së të anëtarëve të Odës janë:
 - 1.1 disponueshmëria e programeve të EVP-së për të gjithë anëtarët e Odës,
 - 1.2 edukimi unik i anëtarëve të Odës në përvetësimin dhe zbatimin e njohurive dhe aftësive profesionale në kryerjen e veprimtarisë profesionale stomatologjike,
 - 1.3 formimi profesional bashkëkohor si dhe informimi për arritjet e reja botërore në fushën e stomatologjisë,
 - 1.4 zgjedhja e lirë në procesin e edukimit profesional, pra mundësia dhe e drejta e secilit anëtar të Odës për të zgjedhur përbajtjen dhe formën e EVP-së.

Neni 8
Aktivitetet në kuadër të EVP-së

1. Anëtarët e Odës mund të zgjedhin aktivitetet e EVP-së në përputhje me këtë rregullore.
2. Aktivitetet në kuadër të EVP-së janë:
 - 2.1 edukimi specialistik
 - 2.2 ligjérata profesionale,
 - 2.3 seminaret,
 - 2.4 simpoziumet,
 - 2.5 takimet e ekspertëve vendas në nivel kongresi/konferencë,
 - 2.6 takimet e ekspertëve ndërkombëtarë në nivel të një kongresi/konferencë ndërkombëtar,
 - 2.7 qendrat studimore,
 - 2.8 studimet e doktoratës,
 - 2.9 botime ne revistat profesionale dhe shkencore,
 - 2.10 kurset për aftësim profesional,
 - 2.11 projektet e shëndetit publik dhe kërkimet shkencore,
 - 2.12 qëndrimi studimor aktiv jashtë shtetit,
 - 2.13 publikimi i librave dhe doracakeve nga fusha e stomatologjisë, dhe
 - 2.14 format tjera të aftësimit profesional.
3. Aktivitetet nga paragrafi 2 i këtij neni paraqesin po ashtu aktivitete në kuadër të EVP-së, që vlerësohen nga KEVP-ja gjatë shqyrtimit të lëndëve të parashtruara.

KAPITULLI II – AKREDITIMI I PLANEVE DHE AKTIVITETEVE TË EVP-SË

Neni 9 Organizimi i aktiviteteve të EVP-së

1. Subjektet e autorizuara për organizim të aktiviteteve të EVP-së janë:
 - 1.1 Shoqatat Profesionale të Stomatologëve,
 - 1.2 Institucionet e arsimit të lartë të akredituara nga organi kompetent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
 - 1.3 Institucionet shëndetësore të tri niveleve të kujdesit shëndetësor,
 - 1.4 Subjektet biznesore që kanë veprimtarinë e regjistruar të ndërlidhur me fushën e stomatologjisë.
2. Oda është po ashtu subjekt i autorizuar për të organizuar aktivitete të EVP-së.
3. Oda në bashkëpunim me institucionet brenda dhe jashtë vendit me të cilat ka të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, mund të organizojnë së bashku aktivitete të EVP-së, me propozim të Kryetarit të OSK-së.
4. Subjektet e autorizuara vendore nga paragrafi 1 i këtij nenit nuk mund të organizojnë brenda vitit më shumë se 1 (një) kongresë/ konferencë.

Neni 10 Plani vjetor i programeve të EVP-së

1. Subjektet e autorizuara nga Neni 9 paragrafi 1 janë të obliguar që me qëllim të organizimit të aktiviteteve të ndryshme të EVP-së, të përgatisin planet vjetore të programeve që do të organizohen në bazë vjetore.
2. Plani vjetor i programeve për EVP duhet të përgatitet nga subjekti i cili parashtron aplikacioni, duke detauar vendin dhe kohën e mbajtjes së aktivitetit, si dhe përbajtjen e saj.
3. Aplikacioni duhet parashtruar nga ana e subjekteve të autorizura jo më vonë se data 15 dhjetor të vitit aktual për vitin e ardhshëm.
4. Plani vjetor i EVP-së miratohet nga Këshilli Drejtues i Odës (në vazhdim KD) me propozimin e KEVP-së.
5. KEVP është i obliguar që deri më 31 dhjetor të vitit aktual të përgatisë propozimin për planin e EVP-së për vitin vijues.

6. Në bazë të propozimit nga paragrafi 5 i këtij neni, KD obligohet të miratojë Planin vjetor të programit të EVP-së deri më 20 janar të vitit të ardhshëm.

Neni 11

Dokumentet e nevojshme për akreditim të aktiviteteve të EVP-së

1. Aplikuesit për akreditim të aktiviteteve, krahas aplikacionit të plotësuar, janë të obliguar që t'i bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
 - 1.1 programin e hollësishëm të aktivitetit duke përfshirë përcaktimin e objektivave, listën e ligjëruesve me CV, abstraktet e punimeve, metodologjinë, orarin dhe vendin e mbajtjes etj,
 - 1.2 certifikatën e regjistrimit të biznesit,
 - 1.3 certifikatën e numrit fiskal,
 - 1.4 dëshminë e pagesës së taksës administrative në shumë të përcaktuar sipas vendimit të organit kompetent të Odës
 - 1.5 në rastet e organizimit të kongreseve, konferencave dhe simpoziumeve, aplikuesit duhet të parashtrojnë raportin e këshillit shkencor mbi punimet e pranuara të cilat do të prezantohen në tubimin e tillë.
2. Nëse një subjekt paraqet tubimin profesional me punë hulumtuese me subjektit njerëzore, patjetër duhet të bashkëngjitet me shkrim pëlqimin e pacientit dhe pëlqimin e Komisionit për Çështje Etike të Odës, ndërsa nëse në punë me pacient merr pjesë profesionisti i huaj, duhet edhe pëlqimi me shkrim prej Ministrisë së Shëndetësisë, dhe sipas nevojës edhe dokumente tjera të përshtatshme.
3. Subjekti i organizimit të tubimit nga paragrafi 2 i këtij neni, duhet të plotësoj kushtet e mëposhtme:
 - 3.1 duhet të ketë kuadër të organizuar profesional për realizimin e tubimit profesional,
 - 3.2 duhet të caktoj personin përgjegjës i cili do të garanton realizimin e programit të tubimit profesional,
 - 3.3 duhet të siguroj regjistrin e të pranishmëve dhe eventualisht verifikimin e njohurive profesionale,
 - 3.4 duhet që KEVP-së t'i dorëzohet regjistri i pjesëmarrësve në afat prej 7 ditëve prej ditës së mbajtjes së tubimit dhe
 - 3.5 përbajtja e programit duhet të jetë në përputhje me këtë rregullore, me respektim të principeve të etikës dhe deontologjisë mjekësore, konventave ndërkombëtare dhe rekomandimeve.
4. Dështimi për të plotësuar dokumentacionin e përcaktuar sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni, paraqet bazë për refuzimin e akreditimit të aktivitetit. Në rastet e refuzimit të akreditimit, çdo taksë administrative e paraparaë sipas akteve ligjore në fuqi nuk i kthehen aplikuesit.
5. Aktivitetet të cilat do të organizohen në bashkëpunim më Odën, nuk do të paguajnë taksën administrative për akreditim si dhe pagesën për certifikatat e lëshuara nga organizatori.

Neni 12

Procedurat e akreditimit të aktiviteteve të EVP-së

1. Procedura për akreditimin e aktiviteteve, iniciohet me dorëzimin e aplikacionit nga ana e organizatorit të aktivitetit që i është bashkangjitur Shtojcës I, dhe i cili duhet plotësuar dhe nënshkruar nga personi i autorizuar i subjektit.
2. Subjekti i autorizuar krahas aplikacionit, duhet të bashkëngjitet dokumentacionin e njëjtë sipas Nenit 10 të kësaj rregulloreje, si dhe përshkrimin e detajizuar të aktivitetit.
3. Afati për parashtrimin e aplikacionit për akreditim të aktivitetit është së paku 30 (tridhjetë) ditë para mbajtjes së aktivitetit.
4. Pas vlerësimit të dokumentacionit për akreditim të aktivitetit, KEVP-ja merr vendimin për akreditim ose jo të aktivitetit. KEVP-ja përcakton numrin e krediteve për aktivitetin që do të akreditohet. Mënyra e përcaktimit të numrit të krediteve bëhet sipas Shtojcës 2 të kësaj rregulloreje.
5. Aktivitetet të cilat akreditohen, si dhe pikët kredituese përkatëse të tyre, do të bëhen të njoitura në web faqen e Odës, më së voni 7 (shtatë) ditë para mbajtjes së aktivitetit.
6. Në rastet kur akreditimi refuzohet, KEVP-ja duhet t'i paraqesë me shkrim aplikuesit arsyet e refuzimit.
7. Në emër të Odës, kryetari i KEVP-së lidh marrëveshje për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella me organizatorin e aktivitetit profesional (Shtojca II).

Neni 13

Kriteret e formës dhe mënyra e lëshimit të certifikatave për aktivitetet e EVP-së

1. Subjekti i aktivitetit është i obliguar që me rastin e përfundimit të aktivitetit t'u lëshojet certifikatë pjesëmarrësve. Certifikata duhet të shtypet në formatin A4.
2. Në certifikatë domosdoshmërisht duhet të vihen këto të dhëna të shtypura në mënyrë elektronike:
 - 2.1 logo e Odës, e cila vendoset në këndin e sipërm të djathjtë të certifikatës. Në këndin e poshtëm të djathjtë duhet të përbajë vendin për nënshkrimin e kryetarit të KEVP-së, në emër të KEVP-së.
 - 2.2 logo e subjektit, e cila vendoset në këndin e sipërm të majtë të certifikatës. Në këndin e poshtëm të majtë duhet të përbajë vendin për nënshkrimin personit të autorizuar të subjektit, në emët të subjektit,
 - 2.3 pikët kredituese,
 - 2.4 vendi dhe data e mbajtjes,
 - 2.5 emri dhe mbiemri i pjesëmarrësit,
 - 2.6 lloji dhe titulli i aktivitetit, duke specifikuar pjesëmarrjen (aktive ose pasive).

3. Certifikatat në të cilat organizator është vetëm Oda, përbajnjë në qendër logon e Odës, ndërsa në këndin e majtë poshtë vendi për nënshkrim të Kryetarit të OSK-së ndërsa në këndin e djathë poshtë, vendi për nënshkrim të Kryetarit të KEVP-së.
4. Subjekti, obligohet që në afat brenda dy (2) jave nga mbajtja e aktivitetit të dorëzojë listën e pjesëmarrësve së bashku me certifikatat për nënshkrim nga kryetari i KEVP-së, si dhe dëshminë e pagesës për certifikatat e lëshuara, në shumë të përcaktuar sipas vendimit për caktimin e lartësisë së taksave administrative të OSK-së.
5. Në rast të refuzimit të akreditimit të aktivitetit, subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë KD në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit me të cilin është refuzuar akreditimi i aktivitetit.

Neni 14 Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar

1. KEVP-ja ka të drejtë të monitorojet aktivitetin e subjektit që është duke u zhvilluar, për të siguruar se a po zbatohet sipas akreditimit të programit.
2. KEVP-ja monitoron, në mënyrë të rastësishme dhe pa njoftim paraprak, vetëm një pjesë të aktiviteteve që akreditohen prej saj. Gjithashtu, KEVP-ja ka të drejtë të realizojë vlerësimin e aktivitetit nga pjesëmarrësit në aktivitet.
3. KEVP-ja cakton një ose më shumë ekspertë të pavarur të fushës, nga lista e përgjedhur nga KEVP-ja, për të monitoruar dhe vlerësuar programin, përfshirë vlerësimin e burimeve të përdorura, ligjëruesit, trajnerët, listën e pjesëmarrësve etj.
4. Pas përfundimit të aktivitetit, monitoruesi përgatit një raport për ecurinë dhe përbajtjen e aktivitetit të mbajtur për KEVP-në.
5. KEVP-ja mund të anulojë akreditimin e ofruar apo të rishikojë numrin e krediteve kur konstatohen shkeljet e mëposhtme:
 - 5.1 Ndryshime në programin e aktivitetit, të cilat cenojnë cilësinë e tij dhe ndikojnë në përllogaritjen e krediteve të miratuara,
 - 5.2 Mos raportimi i konflikteve të interesit të organizatorëve ose/dhe trajnuesve në aktivitet,
 - 5.3 Keqpërdorimi i emrit të institucionit akreditues dhe krediteve të njoitura prej tij,
 - 5.4 Vlerësimi negativ i shumicës së pjesëmarrësve për organizimin e aktivitetit, përbajtjen e temave të veçanta ose nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave.
6. Në rast të shkeljeve të përsëritura nga ana e subjektit, ose në rast shkeljesh të rënda, KEVP-ja ka të drejtën të pezullojë subjektin nga ofrimi i aktiviteteve në vazhdim për një periudhë 6 muaj deri në 1 vit, në varësi të llojit të shkeljes.

Neni 15
E Drejta e Ankesës

1. Ofruesit e aktiviteteve të EVP-së kanë të drejtë të ankohen pranë KEVP-së, për vendimin e akreditimit dhe numrin e pikëve kredituese, brenda 7 (shtatë) ditëve nga momenti i marrjes në dijeni të njoftimit.
2. Çdo ankesë duhet të paraqitet me shkrim dhe të shoqërohet me të dhëna e argumente që mbështetin ankesën. KEVP-ja rishqyrton dosjen e vlerësimit dhe, kur ankesat janë të mbështetura, i reflekton në raportin përfundimtar.
3. Në rastet kur ofruesi nuk është dakord me raportin përfundimtar, ai ka të drejtën e ankesës pranë KD brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes në dijeni të njoftimit të vendimit nga KEVP-ja.
4. Vendimi i KD është përfundimtar.

KAPITULLI III – AFTËSIMI PROFESIONAL

Neni 16
Obligimi i stomatologëve për aftësim të vazhdueshëm profesional dhe portofoli personal i EVP-së

1. Anëtari i Odës, është i obliguar që t'i nënshtrohet EVP-së në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e kujdesit dhe shërbimit që ofron, si dhe të plotësoj kushtet për rilicencim.
2. Anëtar i Odës është i obliguar që brenda 5 (pesë) viteve të grumbullojë në total 100 (njëqind) pikë për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së, duke llogaritur prej datës së lëshimit të licencës së punës.
3. Anëtari i Odës i cili merr pjesë në edukimin mësimor shkencor në thirrje të profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent në drejtimin e stomatologjisë dhe që kanë kontratë pune të lidhur me institucionet e akreditura në Republikën e Kosovës, si dhe anëtari i Odës që është pensionuar për shkakë moshës, lirohet nga detyrimi nga paragrafi 2 i këtij neni.
4. Niveli i tolerancës nga kriteri i paragrafit 2 është deri në 10% e pikëve.
5. Në rastet kur kërkohet rilicencim në lëminë tjeterë specialistike, jashtë fushës së specializimit aktual, aplikuesi obligohet të grumbullojë 50 pikë për rilicencim nga aktivitetet e EVP-së.
6. Stomatologët që janë në specializim, llogariten të kenë vetëm 50% të pikëve, pjesën tjeterë të pikëve obligohet të grumbullojë përmes aktiviteteve të EVP-së, për procedurën e rilicencimit, kjo vetëm gjatë periudhës së rregullt të edukimit specialistik.

7. Çdo ndërprerje e EVP-së me arsyе të dëshmuara, si pushimi i lehonisë, sëmundje të ndryshme personale apo të familjes së ngushtë si dhe arsyе të tjera, lrohen nga obligimi i grumbullimit të pikëve për periudhë kohore deri në një (1) vit. Për periudhën 6 mujore lrohen për 10 pikë, ndërsa për periudhën një (1) vjeçare lrohen për 20 pikë.
8. Stomatologët që i takojnë kategorive sipas paragrafit 7, obligohen që të dorëzojnë pranë KEVP, kërkesën për lirim nga grumbullimi i pikëve së bashku me dokumentacionin i cili dëshmon arsyeshmërinë e pamundësisë së grumbullimit të pikëve që ka qëllim edukimin e vazhdueshëm profesional.
9. Të gjithë stomatologët të cilët nuk arrijnë të bëjnë grumbullimin e pikëve të nevojshme, i nënshtrohen provimit për vlerësimin e njohurive/shkathtësive për lëminë e caktuar, pranë Komisionit për vlerësimin e njohurive/shkathtësive profesionale.

Neni 17 **Portofoli personal i EVP-së**

1. Anëtari i Odës është i obliguar që të dorëzoj kopjet e certifikatave së bashku me originalin, ku certifikata originaire i kthehet menjëherë pas verifikimit në ditën e aplikimit.
2. Të gjitha aktivitetet vendore të pa akredituara nga Oda nuk merren parasysh nga KVEP-ja.
3. Valorizimi i pikëve për pjesëmarrje të aktiviteve do të bëhet sipas Shtojcës IV, në të cilën janë përcaktuar pikët kredituese për secilin lloj të aktivitetit.
4. Me rastin e valorizimit të pikëve, KEVP lëshon certifikatë në të cilën konstaton valorizimin e pikëve nga aktiviteti.
5. Pala e pakënaqur me valorizimin e bërë nga KEVP, ka të drejtë ankesë pranë KD në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të certifikatës për valorizim.
6. Vendimi i KD është përfundimtar.

Neni 18 **Mënyra e llogaritjes së pikëve**

Në pajtim me nenin 16 paragrafi 2, llogaritja e pikëve bëhet ashtu që, çdo vit mund të jenë valide së paku 15 pikë, e më së shumti 25 pikë, duke e llogaritur nga data e lëshimit të licencës së fundit për punë.

Neni 19
Inicimi i procedurës për valorizim

1. Anëtari i Odës inicion procedurën e valorizimit të portofolios personale përmes parashtrimit të aplikacionit që është përcaktuar në Shtojcën III të kësaj rregulloreje.
2. Anëtari i Odës mund të paraqes në KEVP kërkesën për valorizim të pikëve kredituese më së largu 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të afatit të licencës.
3. Aplikacionit të plotësuar me të dhënat relevante dhe deklaratës nën betim duhet t'i bashkëngjiten edhe dokumentet përcjellëse, varësht prej pjesëmarrjes në aktivitetet e EVP-së:
 - 3.1 licenca e punës,
 - 3.2 prezantimi i certifikatave/dëshmi tjetër origjinale për pjesëmarrje aktive apo pasive në aktivitetet e EVP-së në ditën e aplikimit (ju kthehen po atë ditë aplikuesit), apo të njëjtat mund të dorëzohen si fotokopje të noterizuara),
 - 3.3 dëshmitë të publikimeve profesionale dhe shkencore në revistat brenda dhe jasht vendit (nëse aplikuesi ka),
 - 3.4 dëshmi tjera origjinale në ditën e aplikimit (ju kthehen po atë ditë aplikuesit), në varësi të mënyrës së zhvillimit të aktiviteteve profesionale (nëse aplikuesi ka), dhe
 - 3.5 dëshmi për vijueshmérinë e edukimit specialistik (vërtetim nga koordinatori/mentor)
4. Anëtari i Odës i cili ka qenë pjesëmarrës i aktiviteteve të EVP-së jasht vendit, duhet të dorëzoj dëshminë përkatëse për pjesëmarrjen në tubim, ndërsa KEVP e vlerëson me pikë kredituese konform dispozitave të kësaj rregulloreje.

KAPITULLI V – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 20
Hyrja në fuqi

1. Kërkesat për procedurat e valorizimit të pranuara në Odë para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të zgjidhen në përputhje me rregulloren sipas së cilës është nisur procedura.
2. Aktivitete e EVP-së të kryera para hyrjes në fuqi të këtij rregulloreje, do të poentohen në përputhje me vlefshmérinë e rregullores së mëparshme.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Kuvendi i OSK-së dhe nënshkrimit nga Kryetari i OSK-së.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Edukim të Vazhdueshëm Profesional nr. 1066 të datës 26.12.2019 dhe Vendimi me nr.prot, 2581 të datës 14. 11. 2022.

5. Pjesë përbërse e kësaj rregulloreje janë Shtojcat I - IV.
6. Çështjet nga fushëveprimtaria e KEVP-së, të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, procedohen në KD, deri në plotësim-ndryshimin e saj.
7. Kjo rregullore publikohet në web faqen e Odës.



Kryetari i OSK-së

Prof. Dr. Blerim Kamberi

SHTOJCA 1

APLIKACIONI PËR AKREDITIM TË AKTIVITETEVE TË EVP-SË

TË DHËNAT E ORGANIZATORIT		
Emërtimi i subjektit të autorizuar		
Adresa:		
Telefoni:		
E-maili:		
Nënshkrimi:		
TË DHËNA MBI NGJARJEN PROFESIONALE		
	<input type="checkbox"/> Kongres	<input type="checkbox"/> Konferencë
	<input type="checkbox"/> Simpozium	<input type="checkbox"/> Seminar
	<input type="checkbox"/> Kurs profesional	<input type="checkbox"/> Trajnim profesional
	<input type="checkbox"/> Tjetër (shpjego):	
Emri i ngjarjes profesionale:		
Vendi dhe data e mbajtjes:		
Grupi i synuar profesional:		
Kuotizimi: (specifikoni shumën me tië cilën do të ngarkohet pjesëmarrësi.)		
Data e aplikacionit:		
Nënshkrimi i personit përgjegjës:		

Bashkëngjitni informatat në vijim: Programi i detajuar i aktivitetit (objektivat, përbajtja, CV- e ligjëruesve etj); Certifikata e regjistrimit të subjektit të autorizuar.

TERMAT E REFERENCES

Prezantimi i ngjarjes:

Qëllimi i ngjarjes:

Kohëzgjatja:

Aprovimi i KEVP (emri, nënshtetje dhe data e personit autorizues)
/Kjo pjesë plotësohet nga i autorizuari i Komisionit për EVP/

Po Jo

Nëse PO:

Kjo ngjarje poentohet për:

Pjesëmarrës aktiv _____ pikë

Pjesëmarrës pasiv _____ pikë

Nëse JO (arsyeja)

KOMISIONI I EVP-SË

1. 2. 3. 4. 5. 6. 7.

Data:

**MARRËVESHJE PËR TË DREJTAT DHE DETYRIMET E NDËRSJELLA MES
ODËS DHE ORGANIZATORIT TË AKTIVITETIT
PROFESIONAL**

Duke u bazuar në Rregulloren për EVP me nr. prot. të datës.....,
Palët lidhin këtë marrëveshje për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella si vijon:

1. Organizatori (.....) do të mbaj *aktivitetin*..... me dt.në
2. KEVP-ja merr përsipër që te bëj vlerësimin/poentimin e aktivitetit të parashtruar nga organizatori.
3. Organizatori duhet të arsyetoj lartësinë e participimit të eventit dhe të arsyetoj çmimit e caktuar (ky arsyetim bëhet në dokumentin e veçantë që i bashkëngjitet marrëveshjes në fjalë).
4. Organizatori obligohet që të mbaj aktivitetin sipas pikës 1 të kësaj marrëveshjeje.
5. Në bazë të Vendimit mbi lartësinë e taksave të Odës, organizatori obligohet që për aktivitetin në fjalë, për vlerësim/poentim të aktivitetit të paguaj shumën prej 200 euro, në momentin e aplikimit për akreditim të aktivitetit.
6. Për çdo certifikatë të lëshuar 10% të shumës së kuotizimit të pjesëmarrësit në llogari të OSK-së, organizatori duhet të sjellë dëshmi të pagesës jo më vonë se dy (2) javë nga mbajtja e aktivitetit. Nëse pagesa nuk realizohet në afatin e parashtruar, Oda ka të drejtë të tërheq Vendimin e vlerësimit të aktivitetit ndërsa organizatori si dhe pjesëmarrësit njoftohen për këtë. Organizatori i eventit është i obliguar që mjetet e participimit t'i kthej pjesëmarrësve ndërsa pikët kredituese nuk do të llogariten.
7. Organizatori është i obliguar të sigurojë pjesëmarrjen pa pagesë të monitoruesit nga KEVP, me qëllim të monitorimit të mbarëvajtjes së eventit.
8. Palët lidhin këtë marrëveshje për aktivitetin në fjalë dhe obligohen që këtë marrëveshje ta implementojnë.
9. Nëse organizatori i eventit nuk i përbahet kësaj marrëveshjeje, do të sanksionohet sipas Rregullores së EVP-së në fuqi.

Prishtinë:

Kryetari i KEVP

Organizatori i aktivitetit profesional.

VLERËSIMI I AKTIVITETEVE TË EVP-SË SIPAS PIKËVE KREDITUESE

I. PJESEMARRJA NË KONGRESE/KONFERENCA

<i>Kongresi/Konferenca</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (pikët maksimale)</i>		
* Kongresi/Konferenca vendor	Pjesëmarrja aktive	deri	15 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	10 pikë
* Kongresi/Konferenca vendor me pjesëmarrje ndërkontaktore	Pjesëmarrja aktive	deri	20 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	15 pikë
* Kongresi/Konferenca ndërkontaktor jashtë vendit	Pjesëmarrja aktive	deri	20 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	15 pikë

* Dëshmia e certifikatës origjinale për pjesëmarrje aktive apo pasive e lëshuar nga organizatori

II. EDUKIMI SPECIALISTIK

<i>Specializantët dhe mentorimi i tyre</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (pikët maksimale)</i>
* Gjatë kohëzgjatjes së specializimit	10 pikë për secilin vit
** Mentorimi i specializantit	10 pikë për secilin vit

* Dëshmiai/raporti i mentorit të specializantit për vijushmëri të stazhit;

** Dëshmiai për emrin e mentorit klinik nga organi kompetent.

III. STUDIMET PASUNIVERSITARE NË STOMATOLOGJI

<i>Doktoratura</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (pikët maksimale)</i>
* Gjatë kohëzgjatjes së studimeve	10 pikë për secilin vit
* Mbrojtja e doktoratës	20 pikë
* Mentorimi i kandidatit	10 pikë për secilin vit

* Dëshmia nga organi kompetent për vijushmërinë e studimeve;

** Dëshmia për mbrojtjen e doktoratës nga organi kompetent

*** Dëshmia e emërimit të mentorit në studimet e doktoratës

IV. PJESËMARRJA NË SIMPOZIUME/SEMINARE

<i>Simpoziume/Seminare</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (pikët maksimale)</i>			
* Simpozium/Seminar vendor	Pjesëmarrja aktive	deri	5 pikë	
	Pjesëmarrja pasive	deri	3 pikë	
* Simpoziumi/ Seminar vendor me pjesëmarrje ndërkombe tar	Pjesëmarrja aktive	deri	9 pikë	
	Pjesëmarrja pasive	deri	6 pikë	
* Simpozium/Seminar ndërkombe tar	Pjesëmarrja aktive	deri	14 pikë	
	Pjesëmarrja pasive	deri	8 pikë	

* Dëshmia e certifikatës origjinale për pjesëmarrje aktive apo pasive e lëshuar nga organizatori

V. PJESËMARRJA NË KURSE PROFESIONALE

<i>Kurse profesionale</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (piket maksimale)</i>			
* Njëditore	Pjesëmarrja aktive	deri	6 pikë	
	Pjesëmarrja pasive	deri	5 pikë	
* Disaditore	Pjesëmarrja aktive	deri	9 pikë	
	Pjesëmarrja pasive	deri	8 pikë	

* Dëshmia e certifikatës origjinale për pjesëmarrje aktive apo pasive e lëshuar nga organizatori

VI. PUBLIKIMET NË REVISTA SHKENCORE E PROFESIONALE

<i>Llojet e publikimeve</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (pikët maksimale)</i>	
*Revista shkencore të indeksuara në Web of science, Pub Med. dhe Scopus	Autori i parë	20 pikë
	Autori korespondent	15 pikë
	Koautor	10 pikë
**Revista shkencore të indeksuara në plattforma tjera	Autori i parë	15 pikë
	Autori korespondent	10 pikë
	Koautor	5 pikë
*Revista e Stomatologëve të Kosovës	Autori i parë	15 pikë
	Autori korespondent	10 pikë
	Koautor	5 pikë

* Dëshmia e publikimit të punimit në revistë

** Punimet e publikuara në revista të dyshimta të përcaktuara me rregulloren në fuqi të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" nuk do të mirren në konsideratë.

VII. PUBLIKIMET TJERA PROFESIONALE E SHKENCORE

<i>Llojet e publikimeve</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (pikët maksimale)</i>	
* Libri	Autor i librit	20 pikë
	Autor i kapitullit	15 pikë
* Monografia	Autor	15 pikë
	Koautor	10 pikë
* Doracaku	Autori i parë	15 pikë
	Autori korespondent	10 pikë
	Koautor	5 pikë

* Dëshmia e publikimit të botimeve

VIII. TUBIMET/LIGJËRATAT PROFESIONALE

<i>Llojet</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (pikët maksimale)</i>		
* Ligjëratat në Qendrat Rajonale të organizuara nga Oda e Stomatologëve të Kosovës	Pjesëmarrja aktive Pjesëmarrja pasive	deri deri	8 pikë 5 pikë
* Tubimet profesionale të stomatologjisë në kujdesin parësor, dytësor dhe tretësor	Pjesëmarrja aktive Pjesëmarrja pasive	deri deri	5 pikë 3 pikë
* * Tubimet profesionale të mjekësisë në kujdesin parësor, dytësor dhe tretësor	Pjesëmarrja aktive Pjesëmarrja pasive	deri deri	5 pikë 3 pikë

* Dëshmia e certifikatës origjinale për pjesëmarrje

* * Dëshmia e certifikatës për pjesëmarrje.. Vetëm njëherë brenda vitit mund të poentohet për një tubim të tillë.

IX. AKTIVITETET E TË MËSUARIT NË DISTANCË

<i>Lloji</i>	<i>Vlerësimi në pikë kredituese (pikët maksimale)</i>
* Me ndihmën e teknologjisë moderne	Pjesëmarrja deri 6 pikë në një vit

* Ky aktivitet duhet të jetë nga lëmi i stomatologjisë dhe kandidati duhet të sjell dëshminë që ka marr pjesë në këtë aktivitet.

FORMULAR PËR VALORIZIM TË AKTIVITETEVE PËR PIKËT KREDITUESE

Datë: _____/_____/_____

Emri dhe mbiemri
Numri personal
Nr. telefoni
E-mail
Adresa e banimit
Lëmia
Adresa e institucionit ku punon
Kohëzgjatja e kërkuar e licencës (shëno vitet)

Licenca numër..... e vlefshme prej..... deri.....

Dokumentet e nevojshme:

- Kopja e letërmjoftimit,
- Kopja e licencës,
- Kopjet e certifikatave të aktivitetave profesionale pas datës së lëshimit të licencës si dhe origjinali i tyre për verifikim,
- Kopja e diplomës/certifikatës së studimeve pas-diplomike, Vërtetim/dëshmi/mentorim për doktoratë, sipas viteve pas datës së lëshimit të licencës (nëse posedon),
- Vërtetim i mentorit (në rast se aplikuesi është në stazh specialistik), mentorim i specializantit (nëse posedon),
- Dokumentet duhet të dorëzohen në njëren nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time morale dhe penale deklaroj, se të dhënat e shënuara më lartë janë valide dhe të sakta. Jam në dijeni që deklarata e rrejshme është vepër penale në bazë të Kodit Penal të Kosovës.

Nënshkrimi i aplikantit